



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:293756

Datë: 10.12.2024

Numri i dokumentit: 06572110

C.nr.1175/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.Z.H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, kundër të paditurit A.I.H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, për vërtetim pronësie, vlera e kontestit 1,000.00 euro, jashtë seancës, me datë 10.12.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësit B.Z.H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, në lidhje me këtë çështje juridike.

A r s y e t i m

Paditësi B.Z.H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit A.I.H nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, për vërtetim pronësie, vlera e kontestit 1,000.00euro.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit me parashtrësën e datës 20.02.2024, e ka tërhequr padinë ndaj të paditurës së lartcekur.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, duke pas parasysh edhe tërheqjen e padisë ka ardhur në përfundim se padia e paditësve të konstatohet e tërhequr në kuptim të nenit 261 parag. 1 të LPK-së, i cili e përcakton se *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi...”*.

Nga arsyet e cekura më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387 parag. 1 pika c) të LPK –së.

Numri i lëndës: 2021:293756
Datë: 10.12.2024
Numri i dokumentit: 06572110

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
Departamenti i Përgjithshëm / Divizioni Civil,
C.nr.1175/2021, me datë 10.12.2024.

Gj y q t a ri
Avni Berisha

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, konform nenit 261.4 të LPK-së.